

**LIGJI Nr. 04/L-045  
PËR PARTNERITET PUBLIKO PRIVAT**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR PARTNERITET PUBLIKO PRIVAT**

**PJESA I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kornizës ligjore për partneritet publiko privat duke përfshirë procedurat për të hyrë në një partneritet publiko privat, përmbajtjen dhe strukturën e marrëveshjeve për Partneritet Publiko Privat si dhe strukturën institucionale përgjegjëse për menaxhimin dhe zhvillimin e Partneritetit Publiko Privat në Republikën e Kosovës.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

1. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë Partneritetet Publiko Private për ofrimin e shërbimeve publike dhe/ose infrastrukturës publike në të gjithë sektorët ekonomik dhe shoqëror, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- 1.1. transport, duke përfshirë sistemin hekurudhor, transportin në binarë, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, parkingjet, transportin publik;
- 1.2. infrastrukturë energjetike, përjashtuar ndërtimin e kapaciteteve të reja për gjenerim të energjisë;
- 1.3. naftësjellës, gazsjellës, rafinimi dhe distribuimi;
- 1.4. prodhim, distribuim, trajtim, mbledhje dhe administrim të ujit, ujërave të zeza, drenazhës, ujitjes, kanaleve;
- 1.5. mbledhje, deponim, riciklim dhe menaxhim i mbeturinave;
- 1.6. telekomunikacion;
- 1.7. arsim;
- 1.8. sport dhe rekreacion;
- 1.9. shëndetësi;
- 1.10. turizëm dhe kulturë;

- 1.11. infrastrukturë të burgjeve;
- 1.12. rehabilitim i tokës dhe pyjeve;
- 1.13. parqe industriale;
- 1.14. strehim publik, strehim social dhe punë sociale;
- 1.15. ndërtesa qeveritare, administrative dhe publike;
- 1.16. shërbim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës bazuar në TI dhe të dhëna;

2. Ky ligj nuk zbatohet për:

- 2.1. dhënien e licencave, lejeve ose autorizimeve nga Autoritetet Publike, përveç nëse dhënia e licencës, lejes ose autorizimit kërkohet në kuadër të Partneritetit Publiko Privat.
- 2.2. kontratat publike që nuk janë përcaktuar në nën-paragrafin 1.2. të paragrafit 1. të nenit 7 të këtij ligji;
- 2.3. privatizimin e një infrastrukture publike ose ndërmarrjeje publike, sipas Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, përveç nëse në Ligjin për Ndërmarrjet Publike kërkohet zbatimi i dispozitave të këtij ligji;
- 2.4. minierat dhe mineralet dhe të drejtat që ndërlidhen me to, që rregullohen sipas Ligjit Nr. 03/163 për Minierat dhe Mineralet, përveç nëse në Ligjin për Miniera dhe Minerale kërkohet zbatimi i dispozitave të këtij ligji;
- 2.5. ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese energjetike, që rregullohen sipas Ligjit Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë, përveç nëse në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë kërkohet zbatimi i dispozitave të këtij ligji;
- 2.6. të drejtat e ndërlidhura me hapësirën ajrore;
- 2.7. kontratat Publike dhe Koncesionet e klasifikuara sipas Ligjit Nr. 03-L-178 për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë;
- 2.8. kontratat Publike dhe Koncesionet që rregullohen me dispozita të tjera procedurale dhe që jepen:
  - 2.8.1. në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe një ose më shumë shteteve tjera që ka të bëjë me furnizimet ose punët të cilat kanë për qëllim zbatimin e përbashkët ose eksploatimin e një pune nga shtetet nënshkruese ose shërbimet që kanë për qëllim zbatimin e përbashkët ose eksploatimin e një projekti nga shtetet nënshkruese;
  - 2.8.2. në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të lidhur nga Republika e Kosovës që ndërlidhet me stacionimin e trupave dhe që ka të bëjë me ndërmarrjet e një shteti të tretë; dhe
  - 2.8.3. në bazë të një procedure të veçantë të një organizate ndërkombëtare.

### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Autoritet kontraktues** – një autoritet publik i cili ka hyrë në një marrëveshje për partneritet publiko-privat në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

1.2. **Autoritet Publik** - nënkupton:

1.2.1. një ose më shumë ministri ose agjenci të Qeverisë së Republikës së Kosovës;

1.2.2. një ose më shumë komuna;

1.2.3. një ose më shumë ndërmarrje publike ose organe të tjera që rregullohen sipas së drejtës publike;

1.2.4. një bashkim i këtyre autoriteteve dhe organeve të lartpërmendura.

1.3. **Departamenti Qendror i Partneritetit Publiko Privat** ose **Departamenti PPP** - ka kuptimin e përcaktuar me nenin 18 të këtij ligji.

1.4. **Infrastrukturë Publike** - asetet fizike, strukturat dhe sistemet të cilat ofrojnë shërbime publike në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

1.5. **Komiteti për Partneritete Publiko Private** ose **“KPPP”** - ka kuptimin e përcaktuar në nenin 16 të këtij ligji.

1.6. **Koncesion** - Koncesionet e Punëve dhe Koncesionet e Shërbimeve.

1.7. **Koncesion i Punëve** - një kontratë e njëjtë sikurse kontrata e punëve përveç se kryerja e kontratës së tillë kompensohet plotësisht ose pjesërisht me dhënien e të drejtës së shfrytëzimit të objektit të kontratës së tillë.

1.8. **Koncesion i Shërbimit** - një kontratë e njëjtë sikurse kontrata e shërbimit, përveç faktit se kryerja e kësaj kontrate kompensohet plotësisht ose pjesërisht me dhënien e të drejtës së shfrytëzimit të objektit të kontratës së tillë.

1.9. **Konzorcium** - një grup i ofertuesve.

1.10. **Kontratë Shërbimi** - një kontratë, pos një kontrate të furnizimit ose të punëve siç është përkufizuar në Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, që lidhet me një Autoriteti Publik dhe një ose më shumë partnerëve privat, kryerja e të cilës kompensohet me pagesë monetare.

1.11. **Kontratë Pune** - një kontratë ndërmjet një Autoriteti Publik dhe një ose më shumë partnerëve privat që ka detyrë kryesore zbatimin, projektimin dhe përmbushjen, ose realizimin përmes çfarëdo mënyre të një pune ndërtimore ose aktiviteteve të inxhinierisë, kryerja e të cilës kompensohet me pagesë monetare.

1.12. **Kontratë Publike** - do të thotë:

1.12.1. kontrata e shërbimeve;

1.12.2. kontrata e furnizimit;

1.12.3. kontrata e punëve;

1.12.4. kontrata publike kornizë;dhe

1.12.5. kontrata për pronën e paluajtshme siç janë përkufizuar në Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

1.13. **Marrëveshje** - një kontratë ndërmjet një autoriteti publik dhe një partneri privat që ka për qëllim zbatimin e një Partneriteti Publiko Privat dhe të gjitha marrëveshjet paralele dhe ndihmëse duke përfshirë marrëveshjet e financimit, marrëveshjet për operim dhe menaxhim dhe marrëveshjet direkte.

1.14. **Ofertues** ose **ofertuesit** - shoqëritë tregtare, duke përfshirë grupet e personave juridik, të cilët janë pjesëmarrës në një procedurë të përzgjedhjes për një marrëveshje.

1.15. **Organi Shqyrtues i Prokurimit** ose **“OSHP”**- Organ Shqyrtues i Prokurimit Publik i themeluar sipas Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

1.16. **Partner Privat** - personi juridik i cili hyn në një Partneritet Publiko Privat me Autoritetin Publik për ofrimin e infrastrukturës publike dhe shërbimeve publike.

1.17. **Partneriteti Publiko Privat ose PPP** - çdo bashkëpunim kontraktues ose institucional në mes të një ose më shumë Autoriteteve Publike dhe një ose më shumë Partnerëve Privat sipas të cilit partneri privat:

1.17.1. ofron një shërbim publik ose infrastrukturë publike në emër të Autoritetit Publik;

1.17.2. merr përsipër rrezikun financiar, teknik, ndërtimor dhe operativ, duke përfshirë rreziqet e kërkesës dhe/ose disponueshmërisë, në lidhje me ofrimin e shërbimit publik ose infrastrukturës publike;

1.17.3. pranon përfitimet nga ofrimi i shërbimit publik ose infrastrukturës publike në formë të:

1.17.4. pagesës nga autoriteti publik nga buxheti i autoritetit përkatës publik;

1.17.5. taksave ose tarifave të mbledhura prej partnerit privat nga përdoruesit ose klientët e shërbimit publik ose infrastrukturës publike që u ofrohet atyre; ose

1.17.6. një kombinimi të pagesës dhe taksave ose tarifave të lartpërmendura.

1.18. **Përballueshmëria** - detyrimet financiare që barten nga një Autoritet Publik bazuar në kushtet e marrëveshjes që do të përmbushet nga mjetet të cilat janë në kuadër të shpenzimeve aktuale dhe të planifikimit të arsyeshëm të shpenzimeve të ardhshme dhe të cilat janë:

1.18.1. caktuar në buxhetin e Autoritetit Publik për shërbimin publik ose infrastrukturën publike për të cilën është lidhur marrëveshja dhe/ose

1.18.2. caktuar në Buxhetin e Kosovës dhe parashikimet përkatëse buxhetore për Autoritetin Publik në përputhje me ligjet në fuqi.

1.19. **Projekt** - secili nga aktivitetet në vijim ose cilido kombinim i tyre që ushtrohet në kuadër të një Partneriteti Publiko Privat, si vijon:

1.19.1. projektimi, ndërtimi dhe zhvillimi i objekteve të reja të infrastrukturës,

1.19.2. rehabilitimi, modernizimi dhe zgjerimi i objekteve ekzistuese të infrastrukturës;

1.19.3. administrimi, zgjerimi ose shërbimet tjera lidhur me objektet e reja ose ekzistuese të infrastrukturës.

1.20. **Shërbim Publik** - çdo shërbim, detyrë ose funksion të cilin një Autoritet Publik është i mandatuar me ligj që ta ofrojë në interesin e përgjithshëm publik dhe që nuk ka karakter industrial apo komercial.

1.21. **Shërbimet Publike Komunale** - Infrastruktura Publike në pronësi ose që i përket një komune dhe shërbimet publike që ofrohen nga komuna brenda kompetencave të saj ligjore të përcaktuar me ligj.

1.22. **Vlera për Paratë** - sigurimi i një infrastrukture publike ose një shërbim publik nga një Autoritet Publik bazuar në rezultatin e Partneritetit Publiko Privat më të lartë të përfitimit ekonomik, social dhe financiar duke përfshirë koston, çmimin, cilësinë, sasinë, transferimin e rrezikut, apo një kombinim të tyre, krahasuar me sigurimin e infrastrukturës së tillë publike apo të shërbimit publik në ndonjë formë tjetër.

2. Të gjitha referencat në nene të caktuara janë referenca në nenet e këtij ligji, përveç nëse është përcaktuar ndryshe.

#### **Neni 4 Parimet e Përgjithshme**

Dhënia dhe zbatimi i një Partneriteti Publiko Privat bëhet në bazë të parimeve të trajtimit të barabartë, mos-diskriminimit, transparencës, proporcionalitetit, ekonomicitetit, efikasitetit, mbrojtjes së interesit publik, konkurrencës së lirë, vlerës-për-paranë dhe përbalueshmërisë.

### **PJESA II PARTNERITETI PUBLIKO PRIVAT**

#### **KREU I RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR PARTNERITETIN PUBLIKO PRIVAT**

##### **Neni 5 Autorizimi për hyrjen në një Partneritet Publiko Privat**

1. Një Autoritet Publik mund të hyjë në një Partneritet Publiko Privat nëse Autoriteti përkatës Publik, sipas ligjit, është drejtpërdrejtë përgjegjës për ofrimin e një shërbimi publik ose një infrastrukture publike të përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji dhe që është objekti kryesor i Partneritetit Publiko Privat.

2. Kur një Projekt i Partneritetit Publiko-Privat përfshinë ofrimin e shërbimeve publike ose infrastrukturës publike që është përgjegjësi e më shumë se një Autoriteti Publik, KPPP vendosë cili Autoritet Publik është Autoriteti Kontraktues për Partneritetin Publiko Privat përkatës.

3. Në pajtim me dispozitat e nenit 17 të këtij ligji, me miratimin paraprak të Qeverisë, dhe kur është në interes publik, KPPP është e autorizuar që të hyjë në një Partneritet Publiko Privat në emër të Republikës së Kosovës për ofrimin e shërbimeve publike ose infrastrukturës publike që është kompetencë e Qeverisë së Republikës së Kosovës ose cilëso nga Ministritë ose Agjencitë e saj.

## **Neni 6**

### **Fushëveprimi dhe Format e Partneritetit Publiko Privat**

1. Partneriteti Publiko Privat zbatohet ose në formë kontraktuese ose në formë institucionale.
2. Autoriteti Publik zgjedh formën kontraktuese ose institucionale e cila i përgjigjet më së miri ndarjes së dëshiruar të rrezikut dhe përgjegjësive për secilin Partneritet Publiko Privat, duke përfshirë cilindo nga aktivitetet në vijim ose cilindo kombinim të tyre:
  - 2.1. projektimi, ndërtimi, financimi, mirëmbajtja dhe operimi i infrastrukturës së re publike;
  - 2.2. riparimi, modernizimi, financimi, zgjerimi, mirëmbajtja dhe operimi i infrastrukturës ekzistuese publike; dhe/ose
  - 2.3. administrimi, menaxhimi, operimi, mirëmbajtja ose shërbimet tjera që i përkasin shërbimeve publike ose infrastrukturës së re ose ekzistuese publike.

## **Neni 7**

### **Partneriteti Publiko Privat Kontraktues**

1. Partneriteti Publiko Privat Kontraktues mund të jetë në formë të:
  - 1.1. koncesionit, ose
  - 1.2. kontratës Publike, me kusht që në bazë të kësaj kontrate publike partneri privat:
    - 1.2.1. ofron një shërbim publik ose infrastrukturë publike në emër të Autoritetit Publik;
    - 1.2.2. merr përsipër rrezikun dhe përgjegjësitë financiare, teknike, ndërtimore dhe/ose operative në lidhje me ofrimin e shërbimit publik ose infrastrukturës publike;
    - 1.2.3. pranon pagesa të rregullta nga Autoriteti Publik për ofrimin e shërbimit publik ose infrastrukturës publike, pagesa këto që mund të jenë në formë të pagesave të njëanshme, dhe që pasqyrojnë rrezikun e disponueshmërisë, kërkesës ose ndërtimit që është marrë përsipër nga partneri privat.
2. Partneriteti Publiko Privat në formë të Koncesionit rregullohet në bazë të këtij ligji.
3. Dhënia e Partneritetit Publiko Privat në formë të Kontratës Publike siç është përcaktuar në nën-paragrafin 1.2 të paragrafit 1. të këtij neni bëhet në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Në lidhje me të gjitha çështjet tjera, Kontrata Publike e përcaktuar në nën-paragrafin 1.2 të paragrafit 1. të këtij neni rregullohet në bazë të këtij ligji.
4. Rregullat për klasifikimin e kontratave të përziere dhe për kalkulimin e vlerës së përlllogaritur të kontratave të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës zbatohen për koncesionet dhe kontratat e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni

## **Neni 8**

### **Partneriteti Publiko-Privat Institucional**

1. Një partneritet publiko-privat institucional mund të themelohet nga një komunë përmes blerjes nga një ose më shumë partner privat të aksioneve të komunës në një ndërmarrje publike ekzistuese funksioni i vetëm i së cilës është kryerja e një shërbimi publik ose ofrimi i një infrastrukture publike, me kusht që partneri privat po ashtu merr pjesë në drejtimin e ndërmarrjes publike ose merr pjesë në kryerjen e shërbimit publik ose ofrimin e infrastrukturës publike.

2. Përzgjedhja e partnerit privat në këtë partneritet publiko-privat institucional bëhet në bazë të neneve të këtij ligji, kur qëllimi i një partneriteti të tillë publiko-privat institucional është implementimi i një koncesioni të dhënë nga një Autoritet Publik. Në rast se qëllimi i partneritetit publiko-privat institucional është implementimi i ndonjë kontrate tjetër publike, atëherë përzgjedhja e partnerit privat për këtë partneritet publiko-privat institucional bëhet sipas procedurave të prokurimit të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

3. Nëse themelimi i një partneriteti publiko-privat institucional kërkon shitjen e aksioneve në një ndërmarrje publike e cila është në pronësi të Republikës së Kosovës, atëherë themelimi i këtij partneriteti publiko-privat institucional i nënshtrohet miratimit të Qeverisë dhe të Kuvendit të Kosovës në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

### **Neni 9 Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e një Partneriteti Publiko Privat përcaktohet në marrëveshjen gjegjëse. Kohëzgjatja e një Partneriteti Publiko Privat duhet të jetë e ndërlidhur në mënyrë të arsyeshme dhe të pasqyrojë:

- 1.1. ciklin jetësor të infrastrukturës publike,
- 1.2. shkallën e kthimit, dhe
- 1.3. vlerën për paranë të secilit Projekt individual të Partneritetit Publiko Privat.

2. Me miratimin e KPPP, një autoritet kontraktues mund të vazhdojë kohëzgjatjen e marrëveshjes për një periudhë shtesë e cila nuk tejkalon më shumë se  $\frac{1}{4}$  (një të katërtën) e kohëzgjatjes fillestare të përcaktuar në marrëveshje, për arsye të vijim:

- 2.1. vonesat në përfundim ose ndërprerjen në operim, për shkak të rrethanave që janë jashtë kontrollit të arsyeshëm të cilësdo palë;
- 2.2. pezullimi i projektit që ka rezultuar nga veprimet e Autoritetit Kontraktues ose autoriteteve tjera publike; ose
- 2.3. rritja e kostos që ka rezultuar nga kërkesat e Autoritetit Kontraktues që nuk ishin paraparë fillimisht në marrëveshje, nëse partneri privat nuk mund ti kthej këto kosto pa zgjatjen në fjalë;
- 2.4. çfarëdo arsye tjetër e nevojshme për mbrojtjen e interesit publik.

### **Neni 10 Pronësia e Aseteve**

1. Gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes, Autoriteti Kontraktues mundet që përkohësisht t'ia bartë Partnerit Privat pronësinë mbi Infrastrukturën Publike dhe asetet tjera të përcaktuara publike të cilat drejtpërdrejt ndërlidhen me objektin e marrëveshjes, të cilat i kthehen Autoritetit Kontraktues pas skadimit ose ndërprerjes së marrëveshjes në pajtim me kushtet e marrëveshjes.

2. Asnjë mjet sigurues nuk mund të krijohet me marrëveshje mbi pronën publike ose asetet tjera publike që janë të nevojshme për ofrimin e një shërbimi publik ose infrastrukturës publike.

3. Pavarësisht nga paragrafi 2. i këtij neni, aksionarët e Partnerit Privat kanë të drejtën e krijimit të pengut ose të ndonjë mjeti tjetër sigurues në aksionet e tyre në Partnerin Privat.

## **Neni 11 Të Drejtat Financiare**

Partneri privat ka të drejtë të vendosë, pranojë ose mbledhë tarifa ose pagesa për shfrytëzimin e infrastrukturës publike ose ofrimin e shërbimeve publike në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshje.

## **Neni 12 Ndihma Shtetërore për Partneritet Publiko Private**

1. Kur arsyetohet dhe kërkohet në bazë të Vlerës për Para dhe pas miratimit nga KPPP duke përfshirë votën pohuese të Ministrit të Financave, Autoriteti Publik mund të ofrojë mbështetje financiare, buxhetore ose në formë tjetër për të siguruar qëndrueshmërinë, zbatueshmërinë, dhe/ose realizueshmërinë financiare të Projektit. Kjo mbështetje përcaktohet në kërkesën për propozime.

2. Mbështetja financiare ose buxhetore ose ndonjë formë tjetër e mbështetjes e cila i është dhënë një partneriteti publiko-privat në pajtim me këtë ligj nuk i nënshtrohet miratimit të Komisionit për Ndhmën Shtetërore sipas legjislacionit për ndihmën shtetërore, nëse

2.1. partneri privat ka për detyrë të kryej një shërbim publik të përkufizuar në mënyrë të qartë;

2.2. çdo mbështetje financiare, buxhetore apo e formës tjetër e cila i është dhënë partneritetit publiko-privat është caktuar paraprakisht në mënyrë objektive dhe transparente dhe nuk e tejkalon atë çka është e nevojshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet ose pjesë të tyre që shkaktohen me rastin e kryerjes së shërbimit publik;

2.3. partneri privat është përzgjedhur në bazë të një procedure të hapur, transparente dhe konkurruese në pajtim me këtë ligj.

3. Pas aprovimit nga KPPP, Autoriteti Publik mundet gjithashtu t'i sigurojë kompensim Partnerit Privat në rast se gjendja e tij financiare ndikohet negativisht dhe materialisht nga ndryshime të paparashikuara në legjislacionin ose rregulloret të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në Infrastrukturën Publike ose shërbimet publike të cilat i ofron.

4. Nëse një autoritet publik detyrohet të hyjë në borxh ose të jep garancion për të financuar detyrimet e tij ndaj partnerit privat ose për të financuar çfarëdo forme të ndihmës shtetërore për nevojat e implementimit të një partneriteti publiko-privat, atëherë hyrja në borxh, përkatësisht dhënia e garancionit i nënshtrohet dispozitave të Ligjit për Borxhin Publik.

## **Neni 13 Tarifat e Transaksionit dhe Mbikëqyrjes**

1. Autoriteti Publik mund të kërkojë pagesën e një tarife të transaksionit nga partneri privat me qëllim të kompensimit të pjesshëm ose të plotë të kostos që ndërlidhet me transaksionin në fjalë si dhe për të siguruar që ka burime të mjaftueshme financiare në dispozicion për monitorimin e përputhshmërisë me kushtet e marrëveshjes.

2. Autoriteti Publik mund të kërkojë nga partneri privat pagimin e një tarife të mbikëqyrjes, qoftë të njehershme ose në bazë vjetore me qëllim të kompensimit të pjesshëm ose të plotë të kostos që ndërlidhet me monitorimin e përputhshmërisë së të gjitha palëve me marrëveshjen PPP.

3. Shuma e tarifave të transaksionit dhe/ose tarifave të mbikëqyrjes si dhe kushtet për pagimin e këtyre tarifave duhet të përcaktohen në dokumentet e kërkesës për propozime. Pagimi i tarifës së transaksionit dhe/ose të mbikëqyrjes konsiderohet detyrim i pa-negociueshëm dhe i detyrueshëm i ofertuesit të zgjedhur.



4. Të gjitha tarifat e transaksionit dhe të mbikëqyrjes të arkëtuara në pajtim me këtë nen janë para publike të cilat depozitohen në fondin e konsoliduar të Kosovës në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe rregullat përkatëse financiare.

## **KREU II RREGULLAT E POSAÇME PËR KONCESIONET E PUNËVE**

### **Neni 14 Kërkesat për Transparencë dhe Shpallje**

1. Pavarësisht nga paragrafi 2. i nenit 7 të këtij ligji, Autoriteti Publik i cili zhvillon një procedurë e cila rezulton në dhënien e një koncesioni të punëve vlera e të cilit është e barabartë ose tejkalon shumë gjashtë milion e dyqind e dyzet e dymijë (6.242.000) Euro duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar zbaton gjithashtu edhe kërkesat për publikim dhe shpallje të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

2. Koncesionerët e punëve që nuk janë Autoritet Publik plotësojnë kërkesat për publikim dhe shpallje të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe afatet kohore të përcaktuara në këtë ligj për pranimin e kualifikimeve dhe propozimeve nga ofertuesit e interesuar gjatë dhënies së kontratave të punëve për palët e treta kur vlera e këtyre kontratave është e barabartë ose tejkalon shumë gjashtë milion e dyqind e dyzet e dymijë (6.242.000) Euro, duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar.

3. Paragrafi 1. i këtij neni nuk zbatohet për koncesionet e punëve të cilat jepen nga një Autoritet Publik në rastet e përcaktuara në nenet 3 deri 7 të Direktivës së Bashkimit Evropian 2004/17/EC kur këto koncesione të punëve jepen për kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara në atë Direktivë.

### **Neni 15 Nën-kontraktimi**

1. Autoriteti Publik mundet ose:

1.1. të kërkojë nga koncesionari i punëve që të japë kontrata për palët e treta që janë në minimum 30% e vlerës së përgjithshme të punës për të cilën është dhënë koncesioni si dhe njëkohësisht ti japë mundësinë ofertuesve që të rrisin këtë përqindje, ose

1.2. të kërkojë nga ofertuesit për një koncesion të punëve të përcaktojnë në ofertat e tyre përqindjen, nëse ka, të vlerës së përgjithshme të punës për të cilën do të jepet koncesionit të cilin ata kanë për qëllim që tua bartin palëve të treta.

## **PJESA III KOORDINIMI INSTITUCIONAL DHE PËRGJEGJËSITË**

### **Neni 16 Komiteti për Partneritete Publiko Privat i (KPPP)**

1. Komiteti për Partneritete Publiko-Private mbikëqyrë dhe bashkërendon projektet e partneritetit publiko-privat në të gjithë sektorët ekonomik dhe shoqëror.

2. KPPP përbëhet prej pesë (5) anëtarëve të përhershëm. Ministri për Financa është anëtar i përhershëm i KPPP dhe është kryesuesi i KPPP. Katër (4) anëtarët tjerë të përhershëm të KPPP, të cilët duhet të jenë në rang të Zëvendës-Kryeministrit ose të Ministrit, caktohen me vendim të Qeverisë.

3. Në rastet kur Komiteti për Partneritete Publiko-Private shqyrton projekte që kanë të bëjnë me shërbime publike komunale, një përfaqësues i Asociacionit të Komunave të Kosovës ka të drejtë që të merr pjesë në mbledhjen e Komitetit për Partneritete Publiko-Private, në cilësinë e vëzhguesit dhe pa të drejtë vote.

4. Pavarësisht nga paragrafi 2. i këtij neni, KPPP gjithashtu përfshin përfaqësuesin më të lartë të Autoritetit Publik i cili parashikohet të jetë Autoriteti Kontraktues për zbatimin e Projektit të propozuar të PPP, si anëtar i përkohshëm.

5. Anëtarët e përkohshëm të KPPP marrin pjesë në procedurat dhe vendimmarrjen e KPPP vetëm lidhur me projektin specifik që kërkon përfshirjen e tyre.

6. Ministri i Financave drejton dhe koordinon aktivitetet e KPPP si dhe shërben si kryesues i saj.

7. KPPP merr vendimet për miratimin e projekteve dhe marrëveshjeve me shumicë të votave, duke përfshirë votën pohuese të Ministrit të Financave dhe Autoritetit përkatës Kontraktues.

8. Kur KPPP vepron në cilësinë e Autoritetit Kontraktues për një Projekt të caktuar, KPPP merr vendimet për përzgjedhjen e partnerit privat me shumicë të votave, duke përfshirë votën pohuese të Ministrit të Financave.

### **Neni 17 Kompetencat e KPPP**

1. KPPP e ka rolin udhëheqës për zhvillimin e politikave, projekteve dhe programeve të PPP dhe përgatit rekomandime për Qeverinë e Kosovës për shqyrtim dhe miratim nga ajo.

2. KPPP i ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

2.1. zhvillimin dhe menaxhimin e programit kombëtar të PPP;

2.2. zhvillimin e politikave të përgjithshme të PPP;

2.3. nxjerrjen e rregulloreve të zbatimit dhe sqarimeve lidhur me rregullat, procedurat dhe standardet për Projektet e PPP si dhe dokumentet e projektit që janë të detyrueshme për të gjitha Autoritetet Publike;

2.4. nxjerrjen e vendimeve për Autoritetet Publike me qëllim të sigurimit të zbatimit të rregullt të ligjeve dhe rregulloreve që ndërlidhen me një Projekt të PPP;

2.5. shqyrtimin dhe miratimin ose refuzimin e Propozim-Projekteve në bazë të parimit të Vlerës për Para si dhe faktorëve të tjerë në interesin publik;

2.6. identifikimin e Autoriteteve Kontraktuese për Projektet e caktuara;

2.7. veprimin në cilësinë e Autoritetit Kontraktues për Projekte të caktuara;

2.8. miratimin ose refuzimin e Mbështetjes Ekonomike për Projekte;

2.9. mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e performancës së përputhshmërisë dhe ekzekutimit të projektit;

2.10. shqyrtimin dhe miratimin e propozim ndryshimeve dhe plotësimeve e modifikimeve në marrëveshje në bazë të parimit Vlera për Paranë dhe faktorëve të ngjashëm;

2.11. mbajtjen e regjistrit kombëtar të PPP;

2.12. marrjen e vendimeve lidhur me shfrytëzimin e fondeve nga ndarjet buxhetore për PPP dhe

2.13. marrjen e vendimeve tjera relevante lidhur me PPP.

3. Të gjitha Autoritetet Publike kanë të drejtë që të bëjnë rekomandime për KPPP lidhur me zhvillimin e politikave dhe rregulloreve dhe KPPP është e detyruar që t'i shqyrtojë këto rekomandime para marrjes së vendimit.

4. Në rast se një Projekt është në kompetencën e më shumë se një Autoriteti Publik, KPPP cakton Autoritetin ose Autoritetet Kontraktuese për marrëveshjen përkatëse dhe të vendosë procedurat për koordinimin e përgjegjësive.

### **Neni 18** **Departamenti Qendror për PPP**

1. Departamenti Qendror për Partneritetin Publiko Privat (Departamenti PPP) themelohet në kuadër të Ministrisë së Financave për të ndihmuar dhe këshilluar KPPP, Ministrinë e Financave dhe Autoritetet e tjera Publike për të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me Partneritetin Publiko Privat. Departamenti PPP i raporton dhe i përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë KPPP. Departamenti PPP është përgjegjëse për:

1.1. ofrimin e ndihmës, këshillave dhe mbështetjes teknike për Autoritetet Publike dhe për të gjitha çështjet që janë të lidhura me PPP;

1.2. bërjen e rekomandimeve lidhur me kornizën ligjore, rregullatore, institucionale dhe të politikave të PPP;

1.3. zhvillimin dhe shpalljen e procedurave dhe standardeve, në bazë të praktikave të mira ndërkombëtare;

1.4. shqyrtimin dhe nxjerrjen e opinioneve lidhur me qëndrueshmërinë e propozim-projekteve si dhe përgatitjen e rekomandimeve për KPPP dhe Autoritetet Publike;

1.5. shpërndarjen e informatave lidhur me programin PPP dhe projektet individuale;

1.6. përfshirjen e akterëve dhe fushatave publike të edukimit për PPP;

1.7. koordinimin e aktiviteteve lidhur me PPP në të gjithë sektorët ekonomik dhe shoqëror.

2. Për zbatimin e përgjegjësive të tij, Departamenti PPP mund të:

2.1. kërkojë nga Autoritetet Publike që të sigurojnë detale në lidhje me projektet që propozohen, që përgatiten për tenderim, që dalin në tenderim apo që negociohen, apo që janë në proces të zbatimit;

2.2. nxjerrjen e standardeve dhe praktikave e procedurave të rekomanduara për PPP;

2.3. përgatitjen dhe shpërndarjen e informatave dhe udhëzimeve për PPP;

2.4. paraqitjen e propozimeve në KPPP për fuqizimin e kornizës legjislative, rregullatore, institucionale dhe të politikave për PPP;

2.5. koordinimin e asistencës teknike për PPP dhe për projektet specifike të PPP që i ofrohet Autoriteteve Kontraktuese;

2.6. shqyrtimin e projekt-propozimeve, tenderëve dhe kontratave, si dhe sistemeve të menaxhimit të kontratës;

2.7. monitorimin dhe lëshimin e mendimeve lidhur me nivelin e përputhshmërisë së Autoritetit Kontraktues dhe Partnerit Privat me kushtet e marrëveshjes;

2.8. lëshimin e mendimeve teknike për KPPP dhe Autoritetet kontraktuese;

2.9. vlerësimin e rregullt të rezultateve dhe ndikimit të sistemit të PPP;

2.10. përcaktimin nëse një projekt i PPP arsyeton shpenzimin e burimeve shtesë të Ministrisë së Financave ose burimeve tjera jashtë Autoritetit Kontraktues;

2.11. merr pjesë në zhvillimin, zbatimin dhe menaxhimin e cilitdo fond ose instrumenti tjetër të ngjashëm të krijuar për sigurimin e financimit të kapaciteteve që lidhën me zhvillimin dhe zbatimin e një projekti PPP.

3. Ministria e Financave siguron që pozitat kyçe në Departamentin PPP të plotësohen me profesionistë të kualifikuar. Për këtë qëllim, në pajtim me Ligjin për Prokurim Publik, Ministria e Financave mund të kontraktojë shërbime nga ekspertë të jashtëm të kualifikuar profesional dhe/ose teknik, me përdorimin e mjeteve të ndara nga Buxheti i Kosovës, ose nga burimet e jashtme të financimit. Personeli tjetër i Departamentit të PPP, përveç atyre të kontraktuar, janë shërbyes civil të cilët paguhen nga mekanizmat buxhetor që kanë për qëllim tërheqjen dhe mbajtjen e personelit me kualifikim të lartë profesional.

4. Departamenti PPP financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Ministria e Financave siguron që Departamenti PPP ka fonde të mjaftueshme me qëllim të ushtrimit efektiv dhe efikas të përgjegjësive të tij të përcaktuara në këtë ligj.

5. Çdo tarifë e transaksionit, e mbikëqyrjes ose tarifë tjetër, e cila caktohet nga KPPP në pajtim me këtë ligj si dhe mjetet e donatorëve të dhëna specifikisht për mbështetjen e Departamentit PPP, depozitohen në fondin e konsoliduar të Kosovës dhe zotohen përmes procedurës vjetore buxhetore për nevojat e Departamentit PPP në kategorinë përkatëse buxhetore dhe në pajtim me procedurën buxhetore të përcaktuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

### **Neni 19 Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Autoritetit Kontraktues**

1. Autoriteti Kontraktues i gëzon të gjitha të drejtat e përcaktuara në marrëveshje, duke përfshirë por pa u kufizuar, në të drejtën për inspektimin e aktiviteteve të Partnerit Privat sipas marrëveshjes si dhe për të siguruar përputhshmërinë e plotë me kushtet e marrëveshjes.

2. Autoriteti Kontraktues duhet t'i përmbush plotësisht kushtet e marrëveshjes si dhe ti përmbushë detyrimet e tij të përcaktuara në marrëveshje. Përgjegjësitë tjera të Autoriteti Kontraktues përfshijnë:

2.1. realizimin e aktiviteteve përgatitore për një projekt të mundshëm, duke përfshirë të gjitha studimet përkatëse të arsyeshmërisë dhe opsioneve, modelet financiare, analizën vlera-për - paranë si dhe studimet tjera të nevojshme për strukturimin e një Projekti të qëndrueshëm teknikisht dhe financiarisht;

2.2. dorëzimin e propozim-projekteve dhe kërkesave për mbështetje financiare për miratim nga KPPP, në pajtim me këtë ligj dhe rregulloret pasuese;

2.3. themelimi i një ekipi të kualifikuar teknik për menaxhimin e projektit për mbikëqyrjen e procesit të transaksioneve, përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe specifikimeve në pajtim me rregullat e zbatueshme si dhe zhvillimin e procesit të prokurimit për përzgjedhjen e Partnerit Privat dhe lidhjen e marrëveshjes me Partnerin Privat;

2.4. themelimin e një ekipi të kualifikuar profesional për menaxhimin e kontratës, për monitorimin dhe sigurimin e zbatimit të plotë të kushteve të marrëveshjes nga partneri privat.

2.5. sigurimin e informatave, të cilat kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga KPPP dhe Departamenti PPP dhe

2.6. koordinimin e aktiviteteve dhe përputhshmërisë me rregulloret e nxjerra nga KPPP si dhe sqarimet dhe udhëzimet e nxjerra nga Departamenti PPP.

3. Autoriteti Publik lidhë marrëveshjen me Partnerin Privat vetëm nëse Projekti përkatës i PPP është miratuar nga KPPP dhe vetëm nëse janë përmbushur të gjitha kërkesat procedurale dhe materiale të përcaktuara në këtë ligj.

4. Autoriteti Publik vepron në pajtim me të gjitha rregulloret, sqarimet dhe vendimet e lëshuara nga KPPP sipas këtij ligji dhe zbaton standardet dhe procedurat e përpiluara nga Departamenti PPP, nëse është e aplikueshme.

5. Autoriteti Kontraktues është drejtpërdrejtë përgjegjës për çdo ndarje buxhetore të nevojshme për mbulimin e kostos së përgatitjes, zbatimit dhe mbikëqyrjes së Projektit. Në rast se ka më shumë se një Autoritet Kontraktues për një projekt të caktuar, kosto që lidhet me përgatitjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e Projektit mbulohet nga të gjitha Autoritetet Kontraktuese në mënyrë proporcionale, përveç nëse Autoritetet Kontraktuese janë pajtuar ndryshe. Kur KPPP vepron në cilësinë e Autoritetit Kontraktues për një projekt të caktuar, shpërndarja e kostos lidhur me zbatimin e Projektit përcaktohet me vendim të KPPP.

## **Neni 20**

### **Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Partnerit Privat**

1. Partneri privat i gëzon të gjitha të drejtat e përcaktuara në marrëveshje, duke përfshirë por pa u kufizuar, në të drejtën për përdorimin dhe /ose shfrytëzimin e Shërbimit Publik ose Infrastrukturës Publike në pajtim me kushtet e përcaktuara në marrëveshje.

2. Partneri privat duhet me përpikëri t'i plotësojë kushtet e marrëveshjes dhe t'i përmbush detyrimet e përcaktuara në marrëveshje.

3. Me qëllimin e vetëm për të hyrë në marrëveshje dhe për zbatimin e Projektit, ofertuesi i përzgjedhur në pajtim me këtë ligj themelon një shoqëri tregtare në formë të shoqërisë aksionare ose shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e cila inkorporohet në bazë të ligjeve të Kosovës para formalizimit të marrëveshjes. Të gjitha kërkesat lidhur me kapitalin minimal të kërkuar për këtë shoqëri tregtare si dhe procedurat për marrjen e miratimit të Autoritetit Kontraktues për statutin dhe rregulloret e shoqërisë tregtare si dhe për ndryshimet e konsiderueshme në statut ose në rregullore do të përcaktohen në kushtet e kërkesës për propozime dhe duhet të jenë në pajtim me kërkesat e përcaktuara në ligjin e zbatueshëm.

## **Neni 21**

### **Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Shfrytëzuesve të një Shërbimi Publik ose një Infrastruktura Publike**

1. Qytetarët pa asnjë diskriminim do të ketë qasje në infrastrukturën dhe shërbimet publike të ofruar nga një Partner Privat në bazë të një Partneriteti Publiko Privat si dhe do të ketë të drejtë të shfrytëzojnë shërbime cilësore dhe të vazhdueshme me çmime të arsyeshme.

2. Kur kërkohet sipas kushteve të marrëveshjes, shfrytëzuesit duhet të paguajnë tarifa ose pagesa për shfrytëzimin e infrastrukturës publike ose shërbimit publik.

**PJESA IV**  
**IDENTIFIKIMI I PROJEKTEVE POTENCIALE DHE PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E**  
**PARTNERITETEVE PUBLIKO-PRIVATE**

**KREU I**  
**IDENTIFIKIMI I PROJEKTEVE POTENCIALE**

**Neni 22**  
**Identifikimi dhe Miratimi i Projekteve PPP**

1. Çdo Autoritet Publik, KPPP apo Departamenti PPP mund të identifikojnë, propozojnë dhe të iniciojnë një Partneritet Publiko Privat.

2. Të gjitha Projektet PPP, i nënshtrohen miratimit formal nga KPPP para se Autoriteti Publik të iniciojë çfarëdo procedure tenderimi për një projekt të PPP. Miratimi nga KPPP jepet ose refuzohet në bazë të shqyrtimit të studimit të arsyeshmërisë dhe dokumenteve tjera që ndërlidhen me projektin si dhe në bazë të rekomandimeve të Departamentit PPP. Miratimi konfirmon autoritetin publik për projektin PPP. Çdo marrëveshje që lidhet nga një Autoritet Publik pa miratimin e KPPP, është ligjërisht e pavlefshme dhe nuk prodhon efekte juridike

3. Në rast se për një projekt PPP kërkohet të bëhen pagesa nga një autoritet publik te partneri privat, atëherë autoriteti publik, duke marrë parasysh të hyrat e gjeneruara nga projekti:

3.1. ka për detyrë të dëshmojë se janë zotuar mjetet për projektin PPP në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe rregullat përkatëse financiare si dhe në shumën e nevojshme për të përmbushur detyrimet financiare që mund të shfaqen gjatë vitit fiskal kur është paraqitur projekti për miratim; dhe

3.2. ka për detyrë të dëshmojë se, në rast se projekti PPP do të shkaktojë detyrime financiare që duhet të përmbushen nga zotimet buxhetore në vitet e ardhshme fiskale. Shtojcat e bashkëngjitura në Ligjin për buxhetin japin bazë të arsyeshme se mjetet e nevojshme do të zotohen nga autoriteti publik në vitet e ardhshme fiskale për të përmbushur këto detyrime dhe çdo marrëveshje lidhur me projektin dhe palë e së cilës do të jetë autoriteti publik është në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

4. Në rast të shqyrtimit të projekteve që kanë të bëjnë me shërbime publike komunale, Komiteti për Partneritete Publiko-Private miraton projektin nëse plotësohen kriteret si në vijim:

4.1. projekti është në kuadër të kompetencave komunale të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale,

4.2. komuna e ka siguruar financimin adekuat për implementimin e projektit, dhe

4.3. komuna e ka siguruar një ndarje adekuate të rrezikut midis sektorit privat dhe atij publik.

**Neni 23**  
**Studimi i Arsyeshmërisë të Projektit**

1. Para inicimit të procedurave tenderuese të ndonjë projekti PPP, Autoriteti Publik duhet të bëjë një studim i arsyeshmërisë të projektit i cili shërben si bazë për të vendosur nëse Projekti Potencial duhet të zbatohet dhe i cili duhet të dorëzohet tek KPPP kur parashtrohet kërkesa për miratimin e projektit PPP. Studimi i arsyeshmërisë duhet të bazohet në parimin e vlerës-për-paratë si dhe duhet të adresojë arsyeshmërinë ekonomike, sociale teknike dhe financiare të projektit potencial dhe aftësinë e projektit për tërheqjen e partnerëve potencial privat dhe financimit privat si dhe përputhshmërinë e projektit me politikat dhe strategjitë sektoriale dhe kornizën rregulatore dhe ligjore.

2. Departamenti e PPP, duke vepruar në emër të dhe në kuadër të autoritetit të KPPP shqyrtojnë e studimin e arsyeshmërisë të projektit dhe nëse është e nevojshme mund të kërkojë kryerjen e studimeve shtesë, nga Autoriteti Publik para se KPPP të marr vendimin se a është një projekt i autorizuar për tu proceduar për tenderim.

3. Departamenti PPP krijon metodologjinë për të vlerësuar vlerën për paratë për projektet PPP e cila duhet të zbatohet nga të gjitha autoritet kontraktuese gjatë përgatitjes së studimit të arsyeshmërisë.

## **PJESA V PËRZGJEDHJA E PARTNERIT PRIVAT**

### **KREU I PARIMET E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 24**

#### **Dispozitat që rregullojnë procedurat e përzgjedhjes dhe dhënies**

Përzgjedhja e Partnerit Privat bëhet sipas neneve 26 deri në 45 të këtij ligji.

#### **Neni 25**

#### **Fazat e Përzgjedhjes**

Partneri privat përzgjidhet përmes një procedure të para përzgjedhjes, të pasuar nga një procedurë për paraqitjen e propozimeve, sipas këtij ligji.

### **KREU II**

### **PARA-PËRZGJEDHJA E OFERTUESVE**

#### **Neni 26**

#### **Qëllimi dhe Procedura e Para-përzgjedhjes**

1. Pasi që KPPP të ketë aprovuar dhe autorizuar projektin dhe fillimin e procedurës tenderuese në pajtim me këtë ligj, Autoriteti Publik zhvillon një procedurë të para-përzgjedhjes e cila ka për qëllim identifikimin e ofertuesve të cilët i posedojnë kualifikimet e përshtatshme për zbatimin e suksesshëm të koncesionit ose të projektit PPP.

2. Ftesa për pjesëmarrje në procedurën e para-përzgjedhjes publikohet sipas dispozitave përkatëse këtij ligji në formë të kërkesës për kualifikim. Ofertuesit e interesuar kanë jo më pak se njëzet (20) ditë pas publikimit të kërkesës për kualifikim që të përgatisin dhe dorëzojnë aplikacionet e tyre.

3. Kërkesa për kualifikim duhet të përfshijë së paku informatat në vijim:

3.1. një përshkrim të Projektit;

3.2. të dhënat mbi elementet e tjera thelbësore të projektit, siç janë shërbimet të cilat duhet të sigurohen nga partneri privat, masat themelore të performancës si dhe aranzhimet financiare të parashikuara nga Autoriteti Publik;

3.3. një përmbledhje të kushteve kryesore të marrëveshjes së propozuar, nëse ato veç dihen;

3.4. mënyrën dhe kohën për dorëzimin e aplikacioneve për para-përzgjedhje, duke përfshirë afatet e dorëzimit, të shprehura në datë dhe kohë të saktë;

3.5. mënyrën dhe vendin për kërkimin e dokumenteve të para-përzgjedhjes.

- 3.6. kriteret e para-përzgjedhjes sipas nenit 27 të këtij ligji;
- 3.7. periudhën e propozuar kohore për procesin e tenderimit; dhe
- 3.8. kërkesën për inkuorimin e ofertuesit të suksesshëm.

#### **Neni 27** **Kriteret e para-përzgjedhjes**

Për t'u para-përzgjedhur, ofertuesit e interesuar duhet t'i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Ligjin për Prokurim Publik dhe të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë profesionale, ekonomike dhe financiare si dhe kapacitetet teknike dhe profesionale të përcaktuara në kërkesën për kualifikim.

#### **Neni 28** **Pjesëmarrja e Konzorciumeve**

1. Autoriteti Publik, kur fton ofertuesit për pjesëmarrje në procedurën e para-përzgjedhjes, do t'u lejojë atyre formimin e Konzorciumeve ofertuese. Informatat që kërkohen nga anëtarët e Konzorciumeve ofertuese për ta dëshmuar kualifikimin e tyre duhet të paraqiten si për konzorciumin në tërësi ashtu edhe për pjesëmarrësit individual.
2. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në kërkesën për kualifikim, secili anëtar i një konzorciumi mund të marrë pjesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, vetëm në një konzorcium në të njëjtën kohë. Shkelja e kësaj rregulle rezulton me përjashtimin e konzorciumit dhe të anëtarit individual.
3. Gjatë shqyrtimit të kualifikimeve të Konzorciumeve ofertuese, Autoriteti Publik merr parasysh aftësinë dhe shkallën e pjesëmarrjes të secilit anëtar të konzorciumit dhe vlerëson nëse kualifikimet e kombinuara të anëtarëve të konzorciumit janë të përshtatshme për përmbushjen e nevojave të të gjitha fazave të projektit. Autoriteti Publik mund të specifikojë kriteret minimale për pjesëmarrje të anëtarëve kryesor të konzorciumit të cilat konsiderohen esenciale për plotësimin e kushteve të kualifikimit.

#### **Neni 29** **Vendimi mbi para-përzgjedhjen**

Autoriteti Publik merr vendim lidhur me kualifikimet e secilit ofertues i cili ka paraqitur aplikacionin për para-përzgjedhje. Gjatë marrjes së këtij vendimi, Autoriteti Publik përdorë vetëm kriteret e përcaktuara në kërkesën për kualifikim. Të gjithë ofertuesit e para-përzgjedhur më pas ftohen nga Autoriteti Publik për paraqitjen e propozimeve të tyre në përputhje sipas neneve 30 deri 39 të këtij ligji.

### **KREU III** **PROCEDURAT MBI KËRKESËN PËR PROPOZIME**

#### **Neni 30** **Procedurat një-fazëshe dhe dy-fazëshe mbi kërkesën për propozime**

1. Procedurat për kërkimin e propozimeve mund të zhvillohen në 1 ose 2 faza.
2. Kundrejt pagimit të cilësdo takse e cila mund të aplikohet ose caktohet, Autoriteti Publik publikon kërkesën për propozime dhe do t'u sigurojë ofertuesve të para-përzgjedhur një kërkesë për propozime në pajtim me nenin 31 të këtij ligji.
3. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, Autoriteti Publik mund të zhvillojë një procedurë dyfazëshe mbi kërkesën për propozime nga ofertuesit e para-përzgjedhur, nëse elementet e projektit, si p.sh specifikimet e projektit, treguesit e performancës, aranzhimet financiare ose kushtet e kontratës nuk



mund të përshkruhen në kërkesën për propozime në mënyrë mjaft të hollësishme ose të saktë për t'u mundësuar ofertuesve që t'i përgatisin propozimet e tyre përfundimtare.

4. Kur përdoret procedura dy-fazëshe, zbatohen dispozitat në vijim:

4.1. Kërkesa fillestare për propozime duhet të kërkojë nga ofertuesit që në fazën e parë të procedurës të dorëzojnë propozimet e tyre fillestare lidhur me specifikimet e projektit, treguesit e performancës, kushtet financiare dhe karakteristikat tjera të projektit si dhe në lidhje me kushtet kryesore të kontratës të propozuara nga Autoriteti Publik.

4.2. Autoriteti Publik mund të thërrasë mbledhje dhe të zhvillojë diskutime me cilindo ofertues për sqarimin e pyetjeve lidhur me kërkesën fillestare për propozim ose propozimet fillestare dhe dokumentet përcjellëse të dorëzuara nga ofertuesit. Autoriteti publik përgatitë procesverbalin e çdo mbledhje ose diskutimit të këtillë, i cili duhet të përmbajë pyetjet e parashtruara dhe sqarimet e dhëna nga Autoriteti Publik;

4.3. pas shqyrtimit të propozimeve të pranuar, Autoriteti Publik mund të shqyrtojë dhe, sipas nevojës, të ndryshojë kërkesën fillestare për propozim përmes fshirjes ose ndryshimit të cilitdo aspekt të specifikimeve fillestare të projektit, treguesve të performancës, kushteve të financimit ose karakteristikave tjera të projektit, duke përfshirë kushtet kryesore të kontratës si dhe çdo kriter për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve si dhe për përcaktimin e ofertuesit të suksesshëm të përcaktuar në kërkesën fillestare për propozime, si dhe të shtojë karakteristika ose kriteret. Autoriteti publik në procesverbalin e procedurës së zgjedhjes duhet të përfshijë arsyetimet për çfarëdo ndryshimi të kërkesës për propozime. Çdo fshirje, ndryshim ose plotësim i këtillë duhet të theksohet në ftesën për dorëzimin e propozimeve përfundimtare;

4.4. në fazën e dytë të procedurës, Autoriteti Publik i fton ofertuesit që t'i dorëzojnë propozimet e tyre përfundimtare lidhur me një grup të vetëm të specifikimeve të projektit, treguesve të performancës ose kushteve të kontratës, sipas neneve 31 deri 38 të këtij ligji.

### **Neni 31**

#### **Përmbajtja e kërkesës për propozime**

1. Kërkesa për propozime përmban së paku këto të dhëna:

1.1. informatat e përgjithshme të cilat mund të kërkohen nga ofertuesit për përgatitjen dhe dorëzimin e propozimeve të tyre, duke përfshirë informatat mbi afatet për dorëzimin e propozimeve;

1.2. specifikimet e projektit dhe treguesit e performancës, sipas rastit, duke përfshirë kushtet e Autoritetit Publik mbi standardet e sigurisë dhe sigurimit si dhe mbrojtjen e mjedisit;

1.3. kushtet e kontratës të propozuara nga Autoriteti Publik, duke përfshirë një sqarim të kushteve të cilat konsiderohen të pa negociueshme;

1.4. kriteret për vlerësimin e propozimeve, të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues për identifikimin e propozimeve të papërgjegjshme; peshën relative të cilat i është dhënë secilit kriter të vlerësimit; dhe mënyrën në të cilën kriteret aplikohen për vlerësimin dhe refuzimin e propozimeve.

### **Neni 32**

#### **Sigurimi i Tenderit**

1. Kërkesa për propozime duhet të përcaktojë kushtet lidhur me lëshuesin e kërkesës dhe natyrën, formën, shumën dhe kushtet e tjera themelore për sigurimin e kërkuar të tenderit.

2. Ofertuesit mund t'i ekzekutohet sigurimi i kërkuar i tenderit, vetëm në rast të:

- 2.1. tërheqjes ose ndryshimit të propozimit pas skadimit të afatit për dorëzimin e propozimeve;
- 2.2. mos hyrjes në negociatat përfundimtare me Autoritetin Publik sipas paragrafit 1. të nenit 38 të këtij ligji;
- 2.3. mos paraqitjes së ofertës së tij brenda afatit kohor të përcaktuar nga Autoriteti Publik.
- 2.4. mos nënshkrimit të marrëveshjes, pasi që kjo të jetë kërkuar nga Autoriteti Publik, pas pranimit të propozimit;
- 2.5. mos ofrimit të sigurisë së kërkuar për përmbushjen e marrëveshjes pas pranimit të propozimit ose mos plotësimit të cilitdo kusht tjetër të përcaktuar në kërkesën për propozime para nënshkrimit të marrëveshjes.

### **Neni 33 Sqarimet dhe ndryshimet**

1. Autoriteti Publik mundet, me vetiniciativë ose pas kërkesës për sqarime nga një ofertues, ta shqyrtojë dhe sipas rastit ta ndryshojë cilindo element të kërkesës për propozime.

2. Çdo ndryshim duhet tu komunikohet menjëherë të gjithë kandidatëve të cilët kanë pranuar kërkesën për propozime. Nëse Autoriteti Publik e konsideron të nevojshme që t'i ndryshojë dokumentet dhe kur kjo bëhet pas skadimit të dy të tretave (2/3) ose më shumë të periudhës kohore për përgatitjen e ofertave, atëherë Autoriteti Publik e shtyn afatin kohor për dorëzimin e ofertave për një të tretën (1/3) të periudhës fillestare.

3. Në procesverbalin e procedurës së përzgjedhjes, Autoriteti Publik duhet të paraqesë arsyetimet për çfarëdo ndryshimi të kërkesës për propozime. Të gjitha fshirjet, ndryshimet ose plotësimet e këtyre duhet tu komunikohen ofertuesve në të njëjtën mënyrë si kërkesa për propozime.

### **Neni 34 Dorëzimi i propozimeve**

1. Ofertuesit e para-përzgjedhur i dorëzojnë propozimet e tyre në formë të shkruar, të nënshkruara dhe të vëna në zarfe të vulosura.

2. Ofertuesit e para-përzgjedhur kanë të paktën dyzet (40) ditë në dispozicion nga pranimi i kërkesës për propozime për dorëzimin e propozimeve të tyre tek Autoriteti Publik. Propozimi i pranuar nga Autoriteti Publik pas afatit të fundit për dorëzim të propozimeve, nuk do të hapet dhe do të kthehet ofertuesit që e ka dorëzuar atë.

### **Neni 35 Kriteret e vlerësimit**

1. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve teknike përfshijnë, sipas nevojës, të paktën elementet vijuese:

- 1.1. saktësinë teknike;
- 1.2. pajtueshmërinë me standardet mjedisore;
- 1.3. realizueshmërinë operationale dhe efikasitetin;
- 1.4. cilësinë e shërbimeve dhe masat për të siguruar vazhdimësinë e tyre;

- 1.5. potencialin e zhvillimit ekonomik dhe social të ofruar nga propozimet.
2. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve financiare dhe komerciale përfshijnë, kur është e përshtatshme:
  - 2.1. vlerën e tanishme të tarifave të propozuara, çmimet për njësi si dhe ngarkesat tjera gjatë periudhës së marrëveshjes;
  - 2.2. vlerën e tanishme të pagesave të drejtpërdrejta të propozuara nga Autoriteti Publik, nëse ka të tilla;
  - 2.3. koston për aktivitetet e dizajnit dhe ndërtimit, koston e operimit dhe mirëmbajtjes vjetore, vlerën e tanishme të koston kapitale dhe të koston së operimit dhe mirëmbajtjes;
  - 2.4. mbështetjen ekonomike, nëse ka të tillë, që pritet nga Autoriteti Publik;
  - 2.5. qëndrueshmërinë dhe zbatueshmërinë e aranzhimeve financiare të propozuara;
  - 2.6. vlerën aktuale të tarifës së koncesionit që do të paguhet nga Autoriteti Publik; dhe
  - 2.7. potencialin e zhvillimit ekonomik dhe social të ofruar nga propozimet.

### **Neni 36** **Krahasimi dhe vlerësimi i propozimeve**

1. Autoriteti Publik krahason dhe vlerëson secilin propozim në përputhje me kriteret e vlerësimit, peshën relative të dhënë secilit prej atyre kriterëve dhe procesin e vlerësimit të përshkruar në kërkesën për propozime.
2. Për qëllimet e lartpërmendura, Autoriteti Publik mund të përcaktojë kufijtë minimal të cilësisë dhe aspekteve teknike, financiare e komerciale. Propozimet që nuk i arrijnë këta kufij minimal konsiderohen jo të përgjegjshme dhe diskualifikohen.
3. Kur kërkesa për propozime përfshin një konkurs të projektimit, të gjitha propozimet për këtë konkurs të projektimit vlerësohen në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit mbi Prokurimin Publik .

### **Neni 37** **Vërtetimi i mëtejshëm i përmbushjes së kriterëve për kualifikim**

Autoriteti Publik mund të kërkojë nga cilindo ofertues që është para-përzgjedhur, për të vërtetuar sërish kualifikimet e tij në përputhje me kriteret e njëjta të përdorura gjatë para-përzgjedhjes. Autoriteti Publik diskualifikon cilindo ofertues që nuk demonstroi sërish kualifikimet e tij, nëse atij i kërkohet kjo.

### **Neni 38** **Negociatat përfundimtare**

1. Autoriteti Kontraktues renditë të gjitha propozimet e përgjegjshme në bazë të kriterëve të vlerësimit, dhe fton për negociatë finale të marrëveshjes ofertuesin që ka arritur klasifikimin më të mirë.
2. Negociatat finale kanë të bëjnë vetëm me kushtet kontraktuese që janë përcaktuar si të negociueshme në kërkesën përfundimtare për propozime, nëse ka të tilla.
3. Nëse bëhet e qartë për Autoritetin Publik që negociatat me ofertuesin e ftuar nuk do të rezultojnë në marrëveshje brenda një afati të arsyeshëm kohor Autoriteti Publik informon ofertuesin për qëllimin e tij të dhënies fund negociatave dhe do të japë ofertuesit afat prej tridhjetë (30) ditësh për të formuluar ofertën e tij. Nëse Autoriteti Publik nuk e konsideron të pranueshëm atë propozim, do t'u jap fund

negociatave me ofertuesin në fjalë dhe do të ekzekutojë garancitë korresponduese. Autoriteti Publik do të ftojë më pas për negociata ofertuesit tjerë, sipas renditjes së klasifikimit të tyre, deri në arritjen e marrëveshjes apo deri në refuzimin e të gjitha propozimeve të mbetura. Autoriteti Publik nuk do të rifillojë negociatat me ofertuesin me të cilin negociatat janë ndërprerë në përputhje me këtë nen.

4. Pas përfundimit të negociatave dhe para lidhjes së marrëveshjes me ofertuesin e preferuar, Autoriteti Publik dorëzon marrëveshjen përfundimtare në KPPP për miratim. KPPP e refuzon miratimin e marrëveshjes nëse marrëveshja dallon në masë të konsiderueshme nga projekti i miratuar nga KPPP dhe nëse marrëveshja nuk i plotëson kërkesat e ekonomicitetit dhe vlerës për parane, nëse është e aplikueshme. Në rastet kur KPPP refuzon miratimin e marrëveshjes, Autoriteti Publik nuk e lidhë marrëveshjen përkatëse. Çdo marrëveshje e cila lidhet pa miratimin e KPPP është ligjërish e pavlefshme dhe nuk do të prodhojë efekte juridike.

### **Neni 39 Ndërprerja e Procedurave të Prokurimit**

1. Autoriteti Publik ndërpre në aktivitetin e prokurimit para lidhjes së marrëveshjes për arsyet në vijim:
  - 1.1. gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit ka më pak se dy (2) ofertues të kualifikuar;
  - 1.2. të gjithë tenderët e përgjegjshëm nuk janë në pajtim me parimin e vlerës për parane dhe nëse është e aplikueshme përballueshmëria;
  - 1.3. para hapjes së kërkesave për pjesëmarrje ose propozimeve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve dhe/ose arsyeve objektive dhe të vërtetuara dhe/ose që janë jashtë kontrollit të Autoritetit Publik dhe që nuk kanë mundur të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.
2. Menjëherë pas ndërprerjes së aktivitetit të prokurimit, Autoriteti Publik duhet të publikojë njoftimin e anulimit në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe do të përfshijë në shënimet e prokurimit një deklaratë me shkrim në të cilën parashtron arsyet faktike dhe ligjore për ndërprerjen e aktivitetit të prokurimit.

## **KREU IV NEGOCIMI I MARRËVESHJEVE PA PROCEDURA KONKURREUESE**

### **Neni 40 Rrethanat që autorizojnë dhënien e kontratës pa procedura konkurruese**

1. Pas aprovimit nga KPPP, Autoriteti Publik është i autorizuar të negociojë një marrëveshje pa shfrytëzuar procedurat e përcaktuara në nenet 26 deri 39 të këtij ligji në këto raste:
  - 1.1. kur projekti përfshin çështje që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare;
  - 1.2. dhënia e punëve ose shërbimeve shtesë, të cilat nuk janë përfshirë në marrëveshjen fillestare, por të cilat për shkak të rrethanave të paparashikueshme bëhen të nevojshme për kryerjen e punëve ose shërbimeve të përcaktuara në marrëveshje, të cilën autoriteti publik e ka lidhur me partnerin privat, me kusht që marrëveshja është lidhur me partnerin privat, i cili do të kryej këto punë ose shërbime, brenda kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik.

**Neni 41**  
**Procedurat për negociim të marrëveshjeve**

1. Kur marrëveshja negociohet pa shfrytëzim të procedurave konkurruese të tenderit, të përcaktuara në nenet 26 deri në 38, të këtij ligji, Autoriteti Publik:

1.1. përveç për marrëveshjet e negociuara në pajtim me nën-paragrafin 1.1. të paragrafit 1. të nenit 40 të këtij ligji, do të njoftojë qëllimin e tij për nisje të negociatave në lidhje me marrëveshjen, që publikohen në përputhje me dispozitat relevante të këtij ligji;

1.2. do të angazhohet në negociata me po aq persona sa Autoriteti Publik i gjykon si të aftë për zbatim të projektit ashtu si e lejojnë rrethanat;

1.3. do të përcaktojë kriteret e vlerësimit kundrejt të cilave do të vlerësohen dhe klasifikohen propozimet.

**KREU V**  
**DISPOZITAT E NDRYSHME**

**Neni 42**  
**Konfidencialiteti**

Autoriteti Publik do t'i trajtojë propozimet në atë mënyrë që të shmangë zbulimin e përmbajtjes së tyre për ofertuesit konkurrues. Të gjitha diskutimet, komunikimet dhe negociatat ndërmjet Autoritetit Publik dhe ofertuesve janë konfidenciale. Përveç nëse kërkohet me ligj apo me urdhër të gjykatës, apo nëse lejohet nga kërkesa për propozime, asnjë palë në negociata nuk do të bëjë të ditur për cilindo person tjetër cilëndo informatë teknike, për çmimet, apo informata të tjera në lidhje me diskutimet, komunikimet dhe negociatat në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura pa pëlqimin e palës tjetër.

**Neni 43**  
**Publikimi i Njoftimit**

1. Autoriteti Publik duhet të dorëzojë tek Departamenti PPP të gjitha versionet në gjuhë të ndryshme të njoftimit të kërkesës për kualifikim, njoftimit të kërkesës për propozim, të njoftimit të dhënies së kontratës si dhe të njoftimeve të tjera që kërkohen me këtë ligj. Brenda dy (2) ditëve nga pranimi i njoftimit të tillë, Departamenti PPP do të publikon të gjitha versionet në gjuhë të ndryshme të njoftimeve në ueb faqen e Departamentit PPP.

2. Brenda tre (3) ditëve pas dorëzimit të njoftimit tek Departamenti PPP, Autoriteti Publik duhet të publikoj njoftimin në të gjitha gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës në së paku dy gazeta ditore në Kosovë.

3. Departamenti PPP krijon format standarde për njoftimet që referohen në këtë nen.

**Neni 44**  
**Regjistrimi i procedurave të para-përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës**

Autoriteti Publik mbanë shënime lidhur me procedurat e para-përzgjedhjes dhe dhënien e kontratës, në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurim Publik.

**Neni 45**  
**Zbatueshmëria Plotësuese e Ligjit për Prokurim Publik**

Kur një çështje e natyrës procedurale që ndërlidhet me dhënien e një Partneriteti Publiko Privat nuk është e rregulluar me këtë ligj atëherë zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurim Publik. Nëse

për zbatimin e dispozitave përkatëse të Ligjit për Prokurim Publik kërkohet ndonjë aprovim ose vendim i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik ose Agjencisë Qendrore të Prokurimit, autoriteti për dhënien e këtij miratimi ushtrohet nga KPPP.

## **PJESA VI ANKESAT DHE SHQYRTIMI GJYQËSOR**

### **Neni 46 Procedura e Ankesës dhe Shqyrtimit**

1. Nëse një person që merr pjesë në procedurat për dhënien e kontratës të përcaktuar në këtë ligj konsideron se është dëmtuar nga një vendim ose lëshim i një Autoriteti Publik në kundërshtim me dispozitat e Pjesës IV, Kreu II, të këtij ligji, personi në fjalë mund të dorëzojë ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit në pajtim me Ligjin për Prokurim Publik.

2. OSHP shqyrton dhe vendos për ankesën në pajtim me Ligjin për Prokurim Publik.

3. Vendimi i OSHP mund ti nënshtrohet shqyrtimit nga Gjykata Supreme e Kosovës sipas Ligjit për Prokurim Publik.

4. Nëse Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) konstaton se një marrëveshje është lidhur nga Autoriteti Publik në kundërshtim me Pjesën IV, Kreu II, të këtij ligji, kjo marrëveshje nuk mund të zbatohet përveç nëse Gjykata Supreme e Kosovës vendos se vendimi i OSHP është në kundërshtim me faktet ose me ligjin dhe se marrëveshja është e zbatueshme për shkak se:

4.1. kontrata tashmë është kryer plotësisht ose në masë të konsiderueshme; dhe

4.2. duke marrë parasysh pasojat e mundshme negative në interesat e ndryshme, duke përfshirë edhe interesin publik, vjen në përfundim se pasojat negative i tejkalojnë përfitimet që mund të arrihen.

## **PJESA VII MARRËVESHJA PËR PPP**

### **Neni 47 Ligji i zbatueshëm**

1. Marrëveshja zbatohet në bazë të ligjit në fuqi të Republikës së Kosovës, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshje.

2. Partneri privat, aksionarët e tij, dhe partnerët tjerë të biznesit, janë të lirë të zgjedhin ligjin me të cilin rregullohen raportet e tyre.

### **Neni 48 Përmbajtja e marrëveshjes**

1. Marrëveshja lidhet ndërmjet Autoritetit Publik dhe Partnerit Privat, të inkorporuar sipas paragrafit 3. të nenit 20 të këtij ligji.

2. Marrëveshja do të përcaktojë çështjet që konsiderohen të përshtatshme nga palët, duke përfshirë por pa u kufizuar në elementet vijuese:

2.1. natyra dhe shtrirja e punëve që do të kryhen dhe shërbimet që do të ofrohen nga Partneri privat;

- 2.2. kushtet për ofrimin e atyre shërbimeve dhe ekskluzivitetin e të drejtave të Partnerit Privat sipas Kontratës, nëse ka të tillë;
- 2.3. asistencë që Autoriteti Kontraktues mund ta sigurojë për Partnerin Privat në marrjen e licencave dhe lejeve të nevojshme për zbatimin e projektit;
- 2.4. masa deri në të cilën partneri privat është i autorizuar të bëjë nën-kontraktimin e shërbimeve që duhet ti ofrojë sipas marrëveshjes;
- 2.5. kërkesat eventuale që lidhen me themelimin dhe kapitalin minimal të personit juridik të inkorporuar sipas paragrafit 3. të nenit 20 të këtij ligji;
- 2.6. pronësia mbi pronën e paluajtshme dhe asetet tjera që lidhen me projektin dhe obligimet e palëve, ashtu si shihet e përshtatshme, lidhur me përvetësimin e lokacionit të projektit dhe lehtësimet e nevojshme;
- 2.7. pagesa për Partnerin privat, qoftë në formë të tarifave apo ngarkesave për shfrytëzim të objektit të infrastrukturës apo për ofrim të shërbimeve; metodat dhe formulat për caktimin dhe përshtatjen e këtyre tarifave apo ngarkesave; dhe pagesat, që mund të bëhen nga Autoriteti Kontraktues apo nga Autoriteti Publik, nëse ka të tilla;
- 2.8. procedurat për rishikimin dhe aprovimin e projekteve inxhinierike, planeve të ndërtimit dhe specifikimeve nga Autoriteti Kontraktues, dhe procedurat për testim dhe inspektim final, aprovim dhe pranim të objektit të infrastrukturës;
- 2.9. masa deri në të cilën Partneri privat është i detyruar të sigurojë sipas rastit modifikimin e shërbimit për të plotësuar kërkesën reale për shërbime, vazhdimësinë e shërbimit dhe ofrimin e shërbimit nën të njëjtat kushte për të gjithë shfrytëzuesit;
- 2.10. e drejta e Autoritetit Kontraktues apo e Autoritetit tjetër Publik për monitorim të punëve dhe shërbimeve që ofrohen nga partneri privat dhe i kushteve dhe masa deri në të cilën Autoriteti Kontraktues apo Autoriteti tjetër Publik i autorizuar mund të urdhërojë ndryshime sa u përket punëve dhe kushteve të shërbimit apo të ndërmarrë veprime të tjera të arsyeshme që konsiderohen të përshtatshme për të siguruar që objekti i infrastrukturës është duke u operuar si duhet dhe që shërbimet janë duke u ofruar në përputhje me kërkesat e zbatueshme ligjore dhe kontraktuese;
- 2.11. detyrimi i Partnerit Privat për të siguruar raporte dhe informata të tjera për veprimtarinë e tij për Autoritetin Kontraktues apo Autoritetin tjetër Publik;
- 2.12. mekanizmat për adresimin e kostos shtesë dhe pasojave të tjera që mund të rezultojnë nga cilido urdhër i lëshuar nga Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Publik në lidhje me nën-paragrafët 1.9. dhe 1.10. të këtij paragrafi;
- 2.13. në masën që konsiderohet e nevojshme, të gjitha të drejtat e Autoritetit Kontraktues për rishikim dhe aprovim të kontratave të mëdha që lidhen nga partneri privat, në veçanti me aksionarët e Partnerit Privat apo personat tjerë të ndërlidhur, duke përfshirë por pa u kufizuar në transferimin e interesave kontrolluese në partnerin privat;
- 2.14. krijimin e interesave siguroese në asetet e partnerit privat, të drejtat ose interesat sipas marrëveshjes që mund të nevojiten për sigurimin e financimit të nevojshëm për projektin;
- 2.15. garancitë e ndërtimit dhe performancës që ofrohen dhe policat e sigurimit që mbahen nga partneri privat në lidhje me zbatimin e projektit;
- 2.16. mjetet në dispozicion në rast të mospërbushjes së obligimeve nga cilado palë;

2.17. masa deri në të cilën palët mund të përjashtohet nga përgjegjësia për dështim apo vonesë në plotësimin e cilitdo detyrim sipas Kontratës për shkak të rrethanave që janë jashtë kontrollit të arsyeshëm të tyre;

2.18. kohëzgjatja e Kontratës dhe të drejtat e detyrimit e palëve pas skadimit ose ndërprerjes duke përfshirë masat përmblylëse dhe transferuese;

2.19. mënyra për kalkulim të kompensimit në rast të përfundimit të parakohshëm të marrëveshjes;

2.20. ligji i zbatueshëm dhe mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve që mund të shfaqen ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Partnerit Privat;

2.21. të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me informatat konfidenciale.

2.22. kushtet dhe procedurat për ushtrimin e të drejtave të ndërhyrjes nga Autoriteti Kontraktues ose për zëvendësimin e partnerit privat nga subjektet që ofrojnë financim për Projektin;

2.23. identifikimi i institucioneve dhe /apo personelit me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për mbikëqyrje dhe monitorim të kontratës;

2.24. kushtet dhe procedurat për bartjen e detyrimeve të marrëveshjes nga partneri privat;

2.25. procedurat për rishikimin, ndryshimin dhe plotësimin dhe modifikimin e kushteve të marrëveshjes.

3. Departamenti PPP mund të përcaktojë elemente shtesë që duhet të përfshihen në një marrëveshje dhe mund të nxjerrë dispozita standarde dhe udhëzime për hartimin e një marrëveshje.

#### **Neni 49**

#### **Shkëputja e parakohshme e marrëveshjes nga Autoriteti Kontraktues**

Shkëputja e parakohshme e marrëveshjes nga Autoriteti Kontraktues, bëhet vetëm pas miratimit paraprak të KPPP, nëse shkëputja e parakohshme e marrëveshjes rezulton në bërjen e pagesave kompenzuese për partnerin privat apo rezulton në krijimin e çfarëdo obligimi tjetër financiar për Autoritetin Kontraktues ose cilindo Autoritet tjetër Publik.

#### **Neni 50**

#### **Nënshkrimi i marrëveshjes**

Marrëveshja nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i Partnerit Privat dhe nga përfaqësuesi më i lartë i Autoritetit Kontraktues.

### **PJESA VIII**

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 51**

#### **Ligji në fuqi**

1. Me këtë ligj shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-090 Mbi Partneritetet Publiko Private dhe koncesionet në Infrastrukturë dhe procedurat për dhënien e tyre.

2. Në rast të kolizionit midis dispozitave të këtij ligji dhe nenit 54 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dispozitat e këtij ligji kanë epërsi.



## **Neni 52** **Dispozitat Kalimtare**

1. Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit dhe autorizimet paraprake nga KPPP nuk vlejnë për procedurat e tenderimit për Partneritetet Publiko Private kur:

1.1. ofertuesit potencial tashmë janë para-kualifikuar në pajtim me procedurat e caktuara në Ligjin e Prokurimit Publik ose në udhëzimet e prokurimit të caktuara nga ndonjë institucion ndërkombëtar financiar; ose

1.2. një kërkesë zyrtare për dokumentet e propozimeve është publikuar në pajtim me ligjin në fuqi.

2. Në rast se në kohën e shpalljes së këtij ligji, një Projekt PPP është duke u implementuar në mënyrë aktive nën mbikëqyrjen e një komiteti drejtues të projektit të caktuar nga qeveria dhe nëse komiteti drejtues i projektit në fjalë ka finalizuar një prokurim të hapur publik për angazhimin e një këshilltari të kualifikuar të transaksionit në ditën e shpalljes së këtij ligji, komiteti ekzistues drejtues do të veproj si KPPP për të gjitha qëllimet që kanë të bëjnë me implementimin e Projektit deri sa të jepet kontrata në pajtim me këtë ligj.

3. Ky ligj nuk do të zbatohet për kontratat e koncesioneve që tanimë janë nënshkruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kontratat në fjalë ripërtërihen, ndryshohen apo zgjerohen vetëm në pajtim me këtë ligj.

## **Neni 53** **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-045**  
**21 tetor 2011**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-046-2011, datë 15.11.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës**  
**Atifete Jahjaga.**